

**Universiteti i Prishtinës**  
**Fakulteti i Edukimit**

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Vlerësimi në arsim
Niveli:	Master/ Programi: Mësimdhënia dhe Kurrikula
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	2018/19
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Salla Master
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Majlinda Gjellaj
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:Majlinda.gjellaj@uni-pr.edu">Majlinda.gjellaj@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Ky kurs ka për qëllim që studentët të njohin dhe zbatojnë parimet kryesore të procesit të vlerësimit me fokus të theksuar në vlerësimin e brendshëm (vlerësimi në klasë) dhe vlerësimin e jashtëm si dhe bazën filozofike të procesit të vlerësimit. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm, kursi do të trajtojë shtjellimin e koncepteve si vlerësimi formativ (formues) dhe sumativ (përmbledhës), procesi dhe instrumentet e vlerësimit të besueshëm, transparent dhe që i shërben zhvillimit. Këto koncepte do të shtjellohen nga këndvështrimi teorik i literaturës por edhe nga këndvështrimi praktik i kontekstit të sistemit shkollor në Kosovë nën zhvillimet e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Ndërsa, në lidhje me vlerësimin e jashtëm, kursi do të ndihmojë studentët të njihen me qëllimet, të mirat dhe dobësitë e organizimit të vlerësimeve të jashtme në nivel Kosove (testi i maturës; testi i arritshmërisë, testi në klasën e 5-të) dhe në nivel ndërkombëtar (PISA, TIMMS, PIRLS).</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Kursi është menduar si kurs bazë që adreson aspektet teorike dhe praktike të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm që do të shpiente drejt formësimit të praktikave të mira të vlerësimit të brendshëm dhe të kuptuar të mirë të vlerësimeve të jashtme.;

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përshkruajnë parimet kryesore, bazën filozofike të aktiviteteve të vlerësimit;</li> <li>- të analizojnë implikimin e teorive dhe taksonomike të ndryshme të menduarit në aktivitetet e vlerësimit të nxënësve;</li> <li>- të hartojnë instrumente të vlerësimit që demonstrojnë parimet e vlerësimit të mirë;</li> <li>- të analizojnë qëllimet dhe sfidat kryesore në realizimin e testeve shtetërore në Kosovë dhe vlerësimeve ndërkombtare;</li> <li>- të analizojnë qëllimin, funksionet dhe zhvillimet kryesore në vlerësimet ndërkombtare si TIMS; PISA, PIRLS etj.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	15	45
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Metodologjia e mësimdhënies do të jetë e kombinuar ku ligjëruesi ofron udhëzimet dhe kontributin teorik duke u pasuar me aktivitete praktike në klasë dhe midis dy ligjëratave. Detyrat që jepen për vlerësim mendohet të jenë mundësi e zbatimit të ideve në praktikë.		

<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p>Vlerësimi i kursit do të ketë këto aktivitete vlerësuese:</p> <p>Filozofia ime e vlerësimit = 10 %  Prezantimi = 15%  Hartimi i një testi = 15%  Vlerësimi i një ore mësimore 10%  Provimi përfundimtar = 50%  Totali = 100%</p> <table border="1" data-bbox="756 621 1154 863"> <thead> <tr> <th>Pikët</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>90-100 %</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>80- 89 %</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>70- 79 %</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>60- 69 %</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>55-59 %</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table>	Pikët	Nota	90-100 %	10	80- 89 %	9	70- 79 %	8	60- 69 %	7	55-59 %	6
Pikët	Nota												
90-100 %	10												
80- 89 %	9												
70- 79 %	8												
60- 69 %	7												
55-59 %	6												
<p><b>Literatura</b></p>													
<p><b>Literatura bazë:</b></p>	<p>[1] Material i përgatitur nga mësimdhënësi që ofrohet në formë elektronike për studentët (Dispencë)  [2] Musai, B. (2014). <i>Metodologjia e mësimdhënies</i>. Tiranë: CDE (Kapitulli 13, faqe 357-397).  [3] Manual i vlerësimit formativ. Hartuar nga Projekti Basic Education Program.  [4] Marsh, Colin (2009) Konceptet themelore për ta kuptuar kurrikulën. Përkthyer nga CDE Tiranë (faqet 70-92).</p>												
<p><b>Literatura shtesë:</b></p>	<p>Marzano, R. (2010). <i>Formative assessment and standards-based grading</i>. Bloomington: Marzano research laboratory.  Popham, J. (2008). <i>Transformative assessment</i>. Alexandria (US): ACCD.  Éaugh, K., &amp; Gronlund, N. (2013). <i>Assessment of student achievement</i>. Boston: Pearson.  Stiggins, R. (2005). <i>Student-involved assessment for learning</i>. Neë Jersey: Pearson.  Earl, L. (2013). <i>Assessment as learning</i>. California: Corëin.  Popham, J. (2003). <i>Test better, teach better</i>. Alexandria: ASCD.  IPK, 2017, Vlerësimi i nxënësve përmes portfolios</p>												

Burke, K. (2009). *How to assess authentic learning*. California: Corëin.

**Plani i dizajnuar i mësim:**

<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Hyrje në kurs Prezantimi i sillabusit dhe detyrave
<b>Java e dytë:</b>	Politikat dhe dokumentet që rregullojnë fushën e vlerësimit në Kosovë
<b>Java e tretë:</b>	Parimet e vlerësimit; Baza filozofike & Taksonomitë si udhëzues
<b>Java e katërt:</b>	Parimet e vlerësimit; Baza filozofike & Taksonomitë si udhëzues
<b>Java e pestë:</b>	Qëllimet, funksionet dhe llojet e vlerësimit
<b>Java e gjashtë:</b>	Vlerësimi formativ
<b>Java e shtatë:</b>	Vlerësimi formativ/Dhënia e komenteve kthyesë/"Feedback"
<b>Java e tetë:</b>	Vlerësimi sumativ/hartimi i testeve
<b>Java e nëntë:</b>	Testi 1
<b>Java e dhjetë:</b>	Instrumentet e vlerësimit
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Vlerësimet e jashtme në Kosovë
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Vlerësimet e jashtme në Kosovë
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Vlerësimet ndërkombtare
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Vlerësimet ndërkombtare
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Përmbyllje

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Çdo student duhet të:

1. Lexoj literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë, të përgatitet për provimin përfundimtar dhe për të gjitha aktivitetet tjera të klasës.
2. Përgatisë dhe të dorëzojë të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonësë do të ndëshkohet me pikë të humbura.
3. Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara (shih shembuj në Doracakun për Tezën e Masterit dhe shembujve të ofruar nga mësimdhënësi)
4. Nuk lejohet kopjimi dhe plagjiatura.
5. Gjatë orëve mësimore nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe ardhja me vonësë apo largimi nga ora pa arsye.
6. Viojë me rregull ligjëratat sipas dispozitave statutare.

